

Pagesat Nderkombetare ne EUR 'SEPA Credit Transfer (CT)'

Pagesat SEPA CT janë transferta elektronike & fizike në Euro brenda Zonës të Pagesave në Eurozone (SEPA), një iniciativë e Bashkimit Evropian për të thjeshtuar pagesat ndërkufitare. Ato u lejojnë individëve dhe bizneseve të kryejnë pagesa në Euro brenda zonës SEPA me me shume lehtësi dhe shpejtesi ne kohe. Pagesat SEPA CT do te ofrohen me karakteristikat e meposhtme:

1. Orari per datevalute fondesh D (e njejta dite) do te jete ora 15:15 (cdo pagese kundrejt nje SEPA Iban-i/Banke e urdheruar nga klienti brenda ketij orari do te procesohet me D). Pas ores 15:15pm, pagesa procesohet me datevalute fondesh D+1.
2. Komisionet per Pagesat Sepa CT ofrohen me opsionin 'SHA'. Ato jane te mundura per klientet te urdherohen elektronikisht permes platformes digitale ' Raiffeisen On' si dhe ne cdo dege te Bankes ne forme transferte fizike.
3. Komisionet e pagesave SEPA CT Eur jane me te favorshme dhe ne benefit te klienteve kundrejt pagesave Internacionale jo SEPA. Per me shume detaje mbi komisione, orare & afate pagesash SEPA CT, drejtohuni ne listen e Komisioneve dhe Orareve te Pagesave ne faqen zyrtare WEB te Bankes: www.raiffeisen.al (Seksioni: Biznesi Koporate/Terma dhe Kushte).
4. Të gjitha transaksionet SEPA CT janë në Euro në të gjitha fazat e procesit kur llogaria e urdheruesit & perfituesit eshte Eur. Urdheruesi mund te inicjoe nje pagese nga nje llogari me monedhe te ndryshme nga Eur, por vlera e saj e perllogaritur dhe perfituesi duhet te jene ne monedhen Eur.